

L I G J
Nr.9552, datë 5.6.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN “PËR PRIVILEGJET
DHE IMUNITETET E GJYKATËS NDËRKOMBËTARE PENALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen “Për privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4932, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA

MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E GJYKATËS NDËRKOMBËTARE PENALE

Shtetet Palë të kësaj Marrëveshjeje,

duke mbajtur parasysh Statutin e Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare Penale, të miratuar më 17 korrik 1998 nga Konferenca Diplomatike e Autoriteteve të Plotfuqishëm të Kombeve të Bashkuara, i cili krijoi Gjykatën Ndërkombëtare Penale me autoritetin për të ushtruar juridiksionin e saj mbi personat për krimet më të rënda të fushës ndërkombëtare;

duke mbajtur parasysh nenin 4 të Statutit të Romës, i cili parashikon që Gjykata Ndërkombëtare Penale do të ketë personalitet juridik ndërkombëtar dhe zotësi juridike të tillë sa do të jetë e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e synimeve të saj;

duke mbajtur parasysh nenin 48 të Statutit të Romës, i cili parashikon që Gjykata Ndërkombëtare Penale do të gëzojë në territorin e të gjitha Shteteve Palë të Statutit të Romës privilegje dhe imunitete të tilla që janë të nevojshme për përmbushjen e synimeve të saj,

janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1

Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Statuti” nënkupton Statutin e Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, të miratuar në 17 korrik 1998 nga Konferenca Diplomatike e Autoriteteve të Plotfuqishme të Kombeve të Bashkuara mbi Krijimin e një Gjykate Ndërkombëtare Penale;

b) “Gjykata” nënkupton Gjykatën Ndërkombëtare Penale të krijuar nga ana e Statutit;

c) “Shtetet Palë” nënkupton Shtetet Palë të kësaj Marrëveshjeje;

d) “Përfaqësuesit e Shteteve Palë” nënkupton të gjithë përfaqësuesit, zëvendës përfaqësuesit, këshilltarët, ekspertët teknikë dhe sekretarët e delegacioneve;

e) “Asambleja” nënkupton Asamblenë e Shteteve Palë të Statutit;

f) “Gjykatësit” nënkupton gjykatësit e Gjykatës;

g) “Presidenca” nënkupton organin që përbëhet nga Presidenti dhe nga zëvendëspresidentët e parë dhe të dytë të Gjykatës;

h) “Prokuror” nënkupton prokurorin e zgjedhur nga Asambleja në përputhje me nenin 42, paragrafin 4 të Statutit;

i) “Zëvendësprokurorë” nënkuptojnë zëvendësprokurorët e zgjedhur nga Asambleja në përputhje me nenin 42, paragrafin 4 të Statutit;

j) "Referent" nënkupton referentin e zgjedhur nga Gjykata në përputhje me nenin 43, paragrafin 4 të Statutit;

k) "Zëvendësreferent" nënkupton zëvendësreferentin e zgjedhur nga Gjykata në përputhje me nenin 43 paragrafin 4 të Statutit;

l) "Avokati" nënkupton avokatin e mbrojtjes dhe përfaqësuesit ligjorë të viktimave;

m) "Sekretari i Përgjithshëm" nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara;

n) "Përfaqësues të organizatave ndërqeveritare" nënkupton shefat ekzekutivë të organizatave ndërqeveritare, përfshirë edhe çdo zyrtar tjetër që vepron në emrin e tij/ e saj;

o) "Konventa e Vjenës" nënkupton Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961;

p) "Rregullore e Procedurës dhe e Provave" nënkupton Rregulloren e Procedurës dhe të Provave që adoptohet në përputhje me nenin 51 të Statutit.

Neni 2

Statusi ligjor dhe personaliteti juridik i Gjykatës

Gjykata gëzon personalitet juridik ndërkombëtar. Ajo ka gjithashtu edhe një zotësi juridike të tillë, sa do të jetë e nevojshme, për ushtrimin e funksioneve të saj dhe përmbushjen e synimeve të saj. Ajo, në mënyrë të veçantë ka autoritetin të kontraktos, të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe të marrë pjesë në seancat gjyqësore.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës

Gjykata gëzon privilegje dhe imunitete të tilla, që janë të nevojshme për përmbushjen e synimeve të saj, në territoret e të gjitha Shteteve Palë të saj.

Neni 4

Paprekshmëria e godinave të Gjykatës

Godinat e Gjykatës janë të paprekshme.

Neni 5

Flamuri, emblema dhe shenjat dalluese

Gjykata ka të drejtë të vendosë flamurin, emblemën dhe shenjat e saja dalluese në godinat, makinat dhe mbi të gjitha mjetet e tjera të transportit që përdoren për qëllime zyrtare.

Neni 6

Imuniteti i Gjykatës, pronave, fondeve dhe aseteve të saj

1. Gjykata dhe pronat, fondet dhe asetet e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, janë të imunizuara nga çdo lloj forme e procedimeve gjyqësore, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë kur Gjykata shpreh në mënyrë të qartë heqjen dorë nga imuniteti i saj. Megjithatë, kjo nënkupton që asnjë heqje dorë nga imuniteti nuk zbatohet në lidhje me çfarëdolloj mase ekzekutimi.

2. Pronat, fondet dhe asetet e Gjykatës, kudo që ato ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, janë të imunizuara prej kontrollit, përvetësimi rekuizimit, konfiskimit, shpronësimit dhe prej çdo lloj forme tjetër e ndërhyrjes, si nga veprimtaritë ekzekutive, administrative, gjyqësore apo edhe nga ato legjislative.

3. Në hapësirën e nevojshme të kryerjes së funksioneve të Gjykatës, pronat, fondet dhe asetet e Gjykatës, kudo që ato ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, janë të përjashtuara nga kufizimet, rregulloret, kontrollet ose moratoriumet e çdo lloj natyre.

Neni 7

Paprekshmëria e arkivave dhe e dokumenteve

Arkivat e Gjykatës, të gjitha dokumentet dhe dosjet e çdo lloj forme, materialet që dërgohen nga Gjykata apo që i drejtohen asaj, që mbahen nga Gjykata apo që i përkasin asaj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, janë të paprekshme. Mbarimi i afatit të paprekshmërisë ose mosekzistenca e një paprekshmërie të tillë nuk ndikon në masat mbrojtëse që Gjykata mund të urdhërojë në zbatim të Statutit dhe të Rregullores së Procedurës dhe të Provave në lidhje me dokumentet dhe materialet që vihen në dispozicion apo përdoren nga

Gjykata.

Neni 8

Përfshirja nga taksat, detyrimet doganore dhe kufizimeve të importit dhe eksportit

1. Gjykata, asetet e saj, të ardhurat dhe pronat e tjera dhe veprimtaritë e transaksionet e saj janë të përfshira nga të gjitha taksat dhe tatimet e drejtpërdrejta, që përfshijnë ndër të tjera, taksat dhe tatimet mbi të ardhurat, kapitalin dhe korporatën, si dhe taksat e drejtpërdrejta të vëna nga autoritetet lokale dhe provinciale. Megjithatë, kjo nënkupton që Gjykata nuk mund të kërkojë përfshirjen nga taksat të cilat janë në fakt jo më shumë se taksa për shërbime të interesit publik që jepen me një kuotë fikse në përputhje me sasinë e shërbimeve të kryera dhe që mund të identifikohen, përshkruhen dhe specifikohen konkretisht.

2. Gjykata është e përfshirë nga të gjitha detyrimet doganore, taksat dhe tatimet e xhiros së importit dhe ndalimet dhe kufizimet mbi importet dhe eksportet në lidhje me artikujt e importuar apo eksportuar nga Gjykata për përdorimin e saj zyrtar dhe në lidhje me botimet e saj.

3. Mallrat e importuara ose të blera në kushtet e një përfshirjeje të tillë nuk mund të shiten apo të jepen në formë të tjera në territorin e një Shteti Palë përveçse në kushte të rëna dakord me autoritetet përkatëse të atij Shteti Palë.

Neni 9

Rimbursimi i detyrimeve doganore dhe/ ose i taksave të tjera

1. Si rregull i përgjithshëm, Gjykata nuk mund të kërkojë përfshirje nga detyrimet doganore dhe/ ose taksa të tjera që përfshihen në çmimin e pronës së lëvizshme dhe të palëvizshme, si dhe nga taksa që paguhen për shërbimet e kryera. Megjithatë, kur Gjykata, për përdorimin e saj zyrtar, kryen blerje të mëdha të pronave ose të mallrave e të shërbimeve, për të cilat janë ngarkuar apo janë për t'u ngarkuar detyrimet doganore dhe taksa të tjera të identifikueshme, Shtetet Palë duhet të kryejnë marrëveshjet e duhura administrative për përfshirjen nga pagesa të tilla ose rimbursimin e sasisë së detyrimeve doganore dhe/ose taksave të paguara.

2. Mallrat e blera nën kuadrin e këtij përfshirjeje ose rimbursimi nuk mund të shiten ose të jepen në çdo lloj forme përveçse në përputhje me kushtet e parashikuara nga Shteti Palë i cili ka bërë përfshirjen apo rimbursimin. Asnjë përfshirje apo rimbursim nuk mund të bëhet për sa i përket pagesave për shërbime të përdorimit publik që i bëhen Gjykatës.

Neni 10

Fondet dhe liria prej kufizimeve të parasë

1. Duke mos qenë e kufizuar nga kontrollet financiare rregulloret ose moratoriumet financiare të çdo lloji, gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj:

a) Gjykata mund të mbajë fonde, para të çdo lloji ose flori dhe të ketë në funksionim llogari në çdo lloj monedhe;

b) Gjykata është e lirë të transferojë paratë e saj, floririn ose paratë e saj nga një vend në një vend tjetër, ose brenda për brenda çdo vendi dhe të konvertojë çdo lloj paraje që ajo zotëron në çdo lloj tjetër paraje;

c) Gjykata mund të marrë, mbajë, negociojë, transferojë, konvertojë ose të bëjë marrëveshje me obligacionet dhe sigurimet e tjera financiare;

d) Gjykata gëzon trajtim jo më pak të favorshëm se ajo e akorduar nga Shteti Palë i interesuar ndaj çdo organizmi ndërkombëtar ose misioni diplomatik për sa i përket kursit të këmbimit për transaksionet e saj financiare.

2. Në ushtrimin e të drejtave të saj sipas paragrafit 1, Gjykata i kushton vëmendjen e duhur çdo lloj përfshirjeje të bërë nga çdo Shtet Palë për sa ajo konsideron se duhet dhënë kujdes një përfshirjeje të tillë pa dëmtuar interesat e Gjykatës.

Neni 11

Lehtësirat në lidhje me komunikimet

1. Në territorin e çdo Shteti Palë, për qëllime të komunikimeve dhe të korrespondencës së saj zyrtare, Gjykata gëzon një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që jepet nga ana e Shtetit Palë të interesuar çdo organizmi ndërkombëtar apo misioni diplomatik në lidhje me çështje të prioritetit, të çmimeve dhe të taksave që i aplikohen për postën dhe çdo formë tjetër të komunikimit dhe të korrespondencës.

2. Mbi komunikimet zyrtare ose korrespondencës së Gjykatës nuk duhet të zbatohet asnjë lloj censurimi.

3. Gjykata mund të përdorë të gjitha mjetet e përshtatshme të komunikimit, përfshi mjetet elektronike të komunikimit, dhe ka të drejtën të përdorë kodet apo shifrën e vet gjatë komunikimeve dhe korrespondencës së saj zyrtare. Komunikimi dhe korrespondenca zyrtare e Gjykatës është e pacenueshme.

4. Gjykata ka të drejtë të dërgojë dhe marrë korrespondencë dhe materiale të tjera ose të kryejë komunikime me korrierë ose me valixhe të vulosura, të cilat kanë të njëjtat privilegje, imunitete dhe lehtësira si dhe korrierët me valixhet diplomatike.

5. Gjykata ka të drejtë të përdorë pajisje të radios, si dhe pajisje të tjera të telekomunikacionit në ato frekuenca që i jepen asaj nga Shtetet Palë në përputhje me procedurat kombëtare. Shtetet Palë duhet të bëjnë përpjekjet e tyre për t'i dhënë Gjykatës, brenda mundësive të tyre, frekuencat për të cilat ajo ka aplikuar.

Neni 12

Ushtrimi i funksioneve të Gjykatës jashtë selisë së saj

Në rastin kur Gjykata, në zbatim të nenit 3, paragrafit 3 të Statutit, e konsideron të nevojshme të vendoset diku tjetër përveç selisë së saj në Hagë të Holandës, Gjykata mund të lidhë me shtetin në fjalë një marrëveshje në lidhje me dispozitat e lehtësirave të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj.

Neni 13

Përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrës në Asamblesë dhe në organet e saj ndihmëse dhe përfaqësuesit e organizmave ndërqeveritare

1. Përfaqësuesit e Shteteve Pale të Statutit që ndjekin mbledhjet e Asamblesë dhe të organeve të saj ndihmëse, përfaqësuesit e shteteve të tjera që mund të ndjekin mbledhjet e Asamblesë dhe të organeve të saj ndihmëse si vëzhgues në përputhje me nenin 112, paragrafin 1 të Statutit dhe përfaqësuesit e shteteve dhe të organizmave ndërqeveritare të ftuar në mbledhjet e Asamblesë dhe të organeve të saj, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare dhe gjatë udhëtimeve të tyre për vajtjen dhe kthimin nga vendi i mbledhjes, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

- a) Imunitet ndaj arrestimit personal apo ndaj ndalimit të tyre;
- b) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre gjatë funksionit të tyre zyrtar; një imunitet i tillë mund të vazhdojë të jepet pavarësisht se personat në fjalë mund të mos i ushtrojnë më funksionet e tyre si përfaqësues;
- c) Pacenueshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve të çdo lloji forme;
- d) E drejta e përdorimit të kodit apo shifrës, të marrjes së letrave dhe dokumenteve ose korrespondencës me korrier ose me valixhe të vulosur dhe të marrjes dhe të dërgimit të komunikimeve elektronike;
- e) Përrjashtim ndaj kufizimeve të imigracionit, kërkesave të regjistrimit të personave të huaj dhe detyrimeve ndaj shërbimeve kombëtare në Shtetin Palë që ata vizitojnë ose që janë duke kaluar transit gjatë ushtrimit të funksioneve të saj;
- f) Të njëjtat privilegje për sa i përket lehtësirave të parasë dhe të këmbimit të saj siç u jepen edhe përfaqësuesve të Qeverive të huaja me misionet zyrtare të përkohshme;
- g) Të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tyre personale siç u jepen edhe të dërguarve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës;
- h) Të njëjtën mbrojtje dhe lehtësira riatdhesimi siç u jepen edhe agjentëve diplomatikë gjatë kohës së krizave ndërkombëtare sipas Konventës së Vjenës;
- i) Privilegje, imunitete dhe lehtësira të tjera të tilla që nuk janë të papajtueshme me ato që gëzojnë agjentët diplomatikë, me përjashtim të asaj që ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë përjashtim nga detyrimet doganore mbi mallrat e importuara (përveç bagazheve të tyre personale) ose nga taksat indirekte si dhe nga taksat e shitjeve.

2. Kur rastet e çdo lloji forme taksimi varen nga vendbanimi, periudhat gjatë të cilave përfaqësuesit e përshkruar në paragrafin 1 që marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe të organeve të saj ndihmëse janë të pranishëm në një Shtet Palë, nuk do të konsiderohen si periudha banimi për shlyerjen e taksave të tyre.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk janë të zbatueshme si midis një përfaqësuesi dhe autoriteteve të Shtetit Palë të të cilit ai ose ajo është një nënshtetas, ose të Shtetit Palë ose organizmit ndërqeveritar të të cilit ai ose ajo ka qenë një përfaqësues.

Neni 14

Përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse në seancat e Gjykatës

Përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrës në seancat e Gjykatës, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, si dhe gjatë udhëtimeve të tyre për shkuarjen dhe kthimin nga vendi i mbajtjes së seancës, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që përmenden në nenin 13.

Neni 15

Gjykatësit, Prokurori, zëvendësprokurorët dhe referenti

1. Gjykatësit, prokurori, zëvendësprokurorët dhe referenti, kur janë të angazhuar ose duke kryer punët e Gjykatës, gëzojnë të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato që u jepen shefave të misionëve diplomatike, dhe pas mbarimit të mandatit të detyrës së tyre, ata vazhdojnë të mbajnë imunitetin nga proceset gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët që kanë thënë apo shkruar, si dhe veprimet që ata kanë kryer gjatë funksionit të tyre zyrtar.

2. Gjykatësit, Prokurori, zëvendësprokurorët dhe referenti dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë përbërëse e familjes, u jepen të gjitha lehtësirat e mundshme për t'u larguar nga vendi ku ata mund të ndodhen, si dhe për të hyrë apo larguar nga vendi ku është vendosur Gjykata. Në udhëtimet në lidhje me ushtrimin e funksionit të tyre, gjykatësit, prokurori, zëvendësprokurorët dhe referenti, në të gjitha Shtetet Palë përmes të cilave ata mund të kalojnë, gëzojnë të gjitha privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat që Shtetet Palë u japin agjentëve diplomatikë në rrethana të ngjashme sipas Konventës së Vjenës.

3. Nëse një gjykatës, prokurori, një zëvendësprokuror ose referenti, për qëllime të mbajtjes së vetes së tij/të saj në dispozicion të Gjykatës, banon në një nga Shtetet Palë të ndryshëm nga ai shtet ku ai/ajo është një nënshitetas ose me vendbanim të përhershëm, ai ose ajo së bashku me anëtarët e familjes që janë pjesë përbërëse e familjes së tij/të saj, u jepen privilegje, imunitete dhe lehtësira diplomatike gjatë periudhës së qëndrimit të tij/të saj.

4. Gjykatësit, prokurori, zëvendësprokurorët dhe referenti dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesë përbërëse e familjes së tyre u jepen të gjitha lehtësirat e nevojshme të riatdhesimit në kohë të krizave ndërkombëtare ashtu si u jepen agjentëve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës.

5. Paragrafët 1 deri në 4 të këtij neni zbatohen për gjykatësit e Gjykatës edhe pas mbarimit të mandatit të tyre të detyrës, nëse ata vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me nenin 36, paragrafin 10 të Statutit.

6. Pagat, shtesat mbi pagë dhe të ardhurat e tjera financiare që jepen gjykatësve, prokurorit, zëvendësprokurorëve dhe referenti përjashtohen nga taksimet. Kur rastet e çdo lloj forme taksimi varen nga vendi i banimit, periudhat gjatë të cilave gjykatësit, prokurori, zëvendësprokurorët dhe referenti janë të pranishëm në një Shtet Palë për kryerjen e funksioneve të tyre nuk konsiderohen si periudha banimi për qëllime të taksimit. Shtetet Palë mund të marrin në konsideratë këto paga, shtesa mbi pagë dhe të ardhura të tjera financiare për qëllime të vlerësimit të sasisë së taksave që do të zbatohen për të ardhurat nga burime të tjera.

7. Shtetet Palë nuk detyrohen të përjashtojnë nga taksat mbi të ardhurat pensionet mujore apo vjetore që u paguhen ish-gjykatësve, prokurorëve dhe referentëve dhe të personave në ngarkim të tyre.

Neni 16

Zëvendësreferenti, stafi i zyrës së prokurorit dhe stafi i sekretarisë

1. Zëvendësreferenti, stafi i zyrës së prokurorit dhe stafi i sekretarisë gëzojnë privilegje, imunitete dhe lehtësira të tilla që janë të nevojshme për kryerjen në mënyrë të pavarur të funksioneve të tyre. Atyre u jepet:

a) Imunitet ndaj arrestimit personal apo ndaj ndalimit të tyre dhe sekuestrimit të bagazheve personale të tyre;

b) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre gjatë funksionit të tyre zyrtar; një imunitet i tillë mund të vazhdojë të jepet edhe pas mbarimit të punësimit të tyre në Gjykatë;

c) Pacenueshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve të çdo lloji forme dhe materiali;

d) Përjashtim nga taksimi i pagave, shtesave mbi pagë dhe të ardhurave të tjera financiare që u paguhen atyre nga Gjykata. Shtetet Palë mund të marrin në konsideratë këto paga, shtesa mbi pagë dhe të ardhura të tjera financiare për qëllime të vlerësimit të sasisë së taksave që do të zbatohen për të ardhurat nga burime të tjera.

e) Përjashtimin e tyre nga detyrimet e shërbimit kombëtar;

f) Përjashtimin e tyre dhe të anëtarëve që janë pjesë përbërëse e familjes së tyre, nga kufizimet e imigracionit ose të regjistrimit të personave të huaj;

g) Përjashtimin nga inspektimet e bagazheve personale, përveçse në rastet kur ka të dhëna serioze që besohet se bagazhet përmbajnë sende, importi apo eksporti i të cilave është i ndaluar nga ligji ose që i detyrohen kontrollit të rregullorëve të karantinës të Shtetit Palë; një inspektim në një rast të tillë duhet të bëhet në prani të zyrtarit të interesuar;

h) Privilegje të njëjta përsa u përket lehtësirave në lidhje me paranë dhe këmbimin e saj siç u jepen edhe zyrtarëve të rangjeve të barasvlershme të misionëve diplomatike të vendosura në Shtetin Palë të interesuar;

i) Të njëjtat lehtësira riatdhesimi për ata dhe anëtarët në përbërje të familjeve të tyre në kohë të krizave ndërkombëtare, ashtu si u jepen edhe agjentëve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës;

j) Të drejtën për të importuar pa taksë doganore dhe taksë të tjera, përveç pagesave për shërbime, të pajisjeve e mobilie shtëpiake dhe efekteve të tyre në kohën e fillimit të detyrës në Shtetin Palë në fjalë si dhe

të rieksporimit të pajisjeve, mobilieve shtëpiake dhe të efekteve të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera për në vendin e banimit të përhershëm.

2. Shtetet Palë nuk janë të detyruara të përjashtojnë nga taksat mbi të ardhurat pensione mujore apo vjetore që u paguhen ish-zëvendësreferentëve, anëtarëve të stafit të zyrës së prokurorit, anëtarëve të stafit të sekretarisë dhe të personave në ngarkim të tyre.

Neni 17

Personeli lokal i rekrutuar që nuk mbulohet ndryshe nga kjo Marrëveshje

Personelit lokal të rekrutuar nga Gjykata dhe që nuk mbulohet ndryshe nga kjo Marrëveshje i jepet imunitet nga proceset gjyqësore në lidhje me fjalët që mund të kenë thënë apo shkruar dhe të gjitha veprimet e kryera nga ata gjatë funksionit të tyre zyrtar për Gjykatën. Një imunitet i tillë vazhdon të jepet edhe pas mbarimit të punësimit në Gjykatë për aktivitete që kryhen në emër të Gjykatës. Gjatë punësimit të tyre, atyre u jepen gjithashtu edhe lehtësira të tjera të tilla që mund të jenë të nevojshme për ushtrimin në mënyrë të pavarur të funksioneve të tyre për Gjykatën.

Neni 18

Avokati dhe personat që asistojnë avokatin e mbrojtjes

1. Avokati gëzon privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat si më poshtë, në masën e nevojshme për kryerjen e pavarur të funksioneve të tij/të saj, përfshi edhe kohën e kryer për udhëtimet, që lidhen me kryerjen e funksioneve të tij/ të saj dhe që janë objekt i certifikatës të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni:

a) Imunitet ndaj arrestimit personal apo ndaj ndalimit të tyre dhe sekuestrimit të bagazheve personale të tij/të saj;

b) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre që kanë lidhje me autoritetin e tyre zyrtar; një imunitet i tillë vazhdon të jepet edhe pasi ai ose ajo ka mbaruar së kryeri funksionet e tij/të saj;

c) Pacenueshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve të çdo lloji forme dhe materiali që kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij/të saj;

d) Të drejtën e marrjes dhe të dërgimit të letrave dhe dokumenteve në çdo lloji forme, për qëllime të komunikimeve në kryerjen e funksioneve të tij/të saj si avokat;

e) Përjashtimin e tyre nga kufizimet e imigracionit ose të regjistrimit të personave të huaj;

f) Përjashtimin nga inspektimet e bagazheve personale, përveç se në rastet kur ka të dhëna serioze që besohet se bagazhet përmbajnë sende, importi apo eksporti i të cilave është i ndaluar nga ligji ose që i detyrohen kontrollit të rregulloreve të karantinës të Shtetit Palë; një inspektim në një rast të tillë duhet të bëhet në prani të avokatit në fjalë;

g) Privilegje të njëjta përsa u përket lehtësirave në lidhje me paranë dhe këmbimin e saj siç u jepen edhe përfaqësuesve të Qeverive të huaja në misione zyrtare të përkohshme;

h) Të njëjtat lehtësira riatdhësimi të tyre në kohë të krizave ndërkombëtare, ashtu si u jepen edhe agentëve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës.

2. Në momentin e caktimit të avokatit në përputhje me Statutin, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe me rregulloret e Gjykatës, avokati pajiset me një certifikatë me firmën e referentit për periudhën e kërkuar për ushtrimin e funksioneve të tij/të saj. Një certifikatë e tillë dorëzohet nëse autoriteti apo mandati mbaron përpara se të mbarojë afati i vlefshmërisë së certifikatës.

3. Kur rastet e çdo lloji forme taksimi varen nga vendbanimi, periudhat gjatë të cilave avokati është i pranishëm në një Shtet Palë, për kryerjen e funksioneve të tij/të saj, nuk do të konsiderohen si periudha banimi.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në formën *mutatis mutandis*, për personat që asistojnë avokatin mbrojtës në përputhje me nenin 22 të Rregullore së Procedurës dhe të Provave.

Neni 19

Dëshmitarët

1. Dëshmitarët gëzojnë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat në vijim, për masën dhe kohën e nevojshme të paraqitjes së tyre para Gjykatës për qëllime të dhënies së dëshmisë, përfshi edhe kohën e kryer për udhëtimet në lidhje me paraqitjen e tyre përpara Gjykatës, dhe që janë objekt i prodhimit të dokumentit që referohet në paragrafin 1 të këtij neni:

a) Imunitet ndaj arrestimit personal apo ndaj ndalimit të tyre;

b) Pa paragjykime të nënparagrafit (d) të mëposhtëm, imunitet nga inspektimet e bagazheve personale, përveç se në rastet kur ka të dhëna serioze që besohet se bagazhet përmbajnë sende, importi apo eksporti i të cilave është i ndaluar nga ligji ose që i detyrohen kontrollit të rregulloreve të karantinës të Shtetit Palë;

c) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre gjatë dëshmimit të tyre, imunitet i cili vazhdon të jepet edhe pas

paraqitjes së tyre dhe dëshimit para Gjykatës;

d) Pacenueshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve të çdo lloj forme dhe materiale që kanë lidhje me dëshminë e tyre;

e) Të drejtën e marrjes dhe të dërgimit të letrave dhe dokumenteve në çdo lloj forme, për qëllime të komunikimeve të tyre me Gjykatën dhe avokatin që kanë lidhje me dëshminë e tyre;

f) Përrjashtimin e tyre nga kufizimet e imigracionit ose të regjistrimit të personave të huaj, kur ata udhëtojnë për qëllime të dëshmisë së tyre;

g) Të njëjtat lehtësira riatdhësimi të tyre në kohë të krizave ndërkombëtare, ashtu si u jepen edhe agjentëve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës;

2. Dëshmitarët që gëzojnë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni pajisen nga Gjykata me një dokument që vërteton se paraqitja e tyre është kërkuar nga Gjykata dhe që përcakton një afat të përshtatshëm kohor të paraqitjes së tyre.

Neni 20

Viktimat për këtë paraqitje

1. Viktimat pjesëmarrëse në procedimet gjyqësore në përputhje me nenet 89 dhe 91 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave gëzojnë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e mëposhtme, në masën dhe afatet e nevojshme për paraqitjen e tyre para Gjykatës, përfshirë edhe kohën e udhëtimit të tyre që lidhet me paraqitjen përpara Gjykatës, dhe që janë objekt i prodhimit të dokumentit që i referohet paragrafit 2 të këtij neni:

a) Imunitet ndaj arrestimit personal apo ndaj ndalimit të tyre;

b) Imunitet nga sekuestrimet e bagazheve personale, përveçse në rastet kur ka të dhëna serioze që besohet se bagazhet përmbajnë sende, importi apo eksporti i të cilave është i ndaluar nga ligji ose që i detyrohen kontrollit të rregulloreve të karantinës të Shtetit Palë;

c) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre gjatë periudhës së paraqitjes së tyre para Gjykatës, imunitet i cili vazhdon të jepet edhe pas paraqitjes së tyre para Gjykatës;

d) Përrjashtimin e tyre nga kufizimet e imigracionit ose të regjistrimit të personave të huaj, gjatë udhëtimit të tyre vajtje e ardhje nga Gjykata për qëllime të paraqitjes së tyre;

2. Viktimat që marrin pjesë në procedimet gjyqësore në përputhje me nenet 89 dhe 91 të Rregullore së Procedurës dhe të Provave të cilët gëzojnë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, pajisen nga Gjykata me një dokument që vërteton pjesëmarrjen e tyre në procedimet gjyqësore të Gjykatës dhe që përcakton një afat të përshtatshëm kohor të pjesëmarrjes së tyre.

Neni 21

Ekspertët

1. Ekspertëve që kryejnë funksione për Gjykatën u jepen privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e mëposhtme, në masën dhe periudhën kohore të nevojshme për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre, përfshi edhe kohën e kryer për udhëtimet, që lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre dhe që janë objekt i certifikatës që përmendet në paragrafin 2 të këtij neni:

a) Imunitet ndaj arrestimit personal apo ndaj ndalimit të tyre dhe sekuestrimit të bagazheve personale të tyre;

b) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre gjatë periudhës kohore të ushtrimit të funksioneve të tyre për Gjykatën, imunitet i cili vazhdon të jepet edhe pasi ata kanë mbaruar së kryeri funksionet e tyre;

c) Pacenueshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve të çdo lloj forme dhe materiale që kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre për Gjykatën;

d) Për qëllime të komunikimeve të tyre me Gjykatën, të drejtën e marrjes dhe të dërgimit të letrave dhe dokumenteve në çdo lloj forme, dhe materiale që lidhen me funksionet e tyre për Gjykatën me korrier ose me valixhe të vulosura;

e) Përrjashtimin nga inspektimet e bagazheve personale, përveç se në rastet kur ka të dhëna serioze që besohet se bagazhet përmbajnë sende, importi apo eksporti i të cilave është i ndaluar nga ligji ose që i detyrohen kontrollit të rregulloreve të karantinës së Shtetit Palë në fjalë; një inspektim në një rast të tillë duhet të bëhet në prani të ekspertit në fjalë;

f) Privilegje të njëjta përsa u përket lehtësirave në lidhje me paranë dhe këmbimin e saj siç u jepen edhe përfaqësuesve të qeverive të huaja në misionet zyrtare të përkohshme;

g) Të njëjta lehtësira riatdhësimi të tyre në kohë të krizave ndërkombëtare, ashtu si u jepen edhe agjentëve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës;

h) Përrjashtimin e tyre nga kufizimet e imigracionit ose të regjistrimit të personave të huaj në lidhje me funksionet e tyre siç specifikohet në dokumentin që i referohet paragrafit 2 të këtij neni

2. Ekspertët që gëzojnë privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni,

pajisen nga Gjykata me një dokument që vërteton që ata po kryejnë funksione për Gjykatën dhe që përcakton një afat të përshatshëm të kohëzgjatjes së këtyre funksioneve.

Neni 22

Persona të tjerë që kërkohen të jenë të pranishëm në selinë e Gjykatës

1. Persona të tjerë që kërkohet të jenë të pranishëm në selinë e Gjykatës, në masën dhe kohën e nevojshme për prezencën e tyre në selinë e Gjykatës, përfshirë dhe kohën e kryer gjatë udhëtimit në lidhje me prezencën e tyre, u jepen privilegje, imunitete dhe lehtësira të parashikuara sipas nenit 20, paragrafi 1, nënparagrafët (a) deri (d) të kësaj Marrëveshjeje, që kanë të bëjnë me prodhimin e dokumentit që i referohet paragrafit 2 të këtij neni.

2. Persona të tjerë që nevojiten të jenë të pranishëm në selinë e Gjykatës, pajisen nga Gjykata me një dokument që vërteton se atyre u kërkohet të paraqiten në këtë Gjykatë, dhe që përcakton një afat gjatë të cilit prezenca e tyre është e nevojshme në Gjykatë.

Neni 23

Nënshtetasit dhe rezidentët e përhershëm

Në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit çdo shtet mund të deklarojë që:

a) Pa cenuar paragrafin 6 të nenit 15 dhe paragrafin 1(d) të nenit 16, një person i cili përmendet në nenet 15, 16, 18, 19 dhe 21, në territorin e Shtetit Palë të të cilit ai/ajo është një nënshtetas ose një rezident i përhershëm, gëzon vetëm privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme, në masën dhe kohën e nevojshme për kryerjen e pavarur të funksioneve të tij/të saj ose të paraqitjes ose dëshmimit të tij/të saj përpara Gjykatës:

i) Imunitet nga arrestimi personal dhe ndalimi;

ii) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre, dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre gjatë periudhës kohore të ushtrimit të funksioneve të tyre për Gjykatën, ose gjatë paraqitjes dhe dëshmimit të tij/të saj, imuniteti i cili vazhdon t'i jepet personit edhe pasi ai/ajo kanë mbaruar së kryeri funksionet e tyre për Gjykatën ose paraqitjen ose dëshminë përpara saj;

iii) pacenueshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve të çdo lloji forme dhe materiale që kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre për Gjykatën ose paraqitjen ose dëshmimin e tij/e saj përpara saj;

iv) Të drejtën e marrjes dhe të dërgimit të letrave dhe dokumenteve në çdo lloji forme për qëllime të komunikimeve të tyre me Gjykatën dhe për një person i cili përmendet në nenin 19, me avokatin e tij/të saj në lidhje me dëshminë e tij/ të saj.

b) Një person, i cili përmendet në nenet 20 dhe 22, në territorin e Shtetit Palë të të cilit ai ose ajo është një nënshtetas ose rezident i përhershëm, gëzon vetëm privilegjet dhe iminitetet e mëposhtme, në masën dhe kohën e nevojshme për paraqitjen përpara Gjykatës:

i) Imunitet nga arrestimi personal dhe ndalimi;

ii) Imunitet ndaj proceseve gjyqësore të çdo lloji në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara nga ana e tyre dhe të gjitha veprimeve të kryera prej këtij personi gjatë periudhës kohore të paraqitjes të tij/të saj para Gjykatës, imuniteti i cili vazhdon të jepet edhe pasi ai/ajo ka mbaruar paraqitjen përpara Gjykatës.

Neni 24

Bashkëpunimi me autoritetet e Shteteve Palë

1. Gjykata duhet të bashkëpunojë në vijimësi me autoritetet e nevojshme të Shteteve Palë për të lehtësuar zbatimin e ligjeve të tyre dhe për të parandaluar ndodhjen e ndonjë abuzimi në lidhje me privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat që i referohen kësaj Marrëveshjeje.

2. Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet, është detyra e të gjithë personave që i gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e kësaj Marrëveshjeje të respektojnë ligjet dhe rregulloret e Shtetit Palë, në territorin e të cilit ata mund të gjenden me detyrë në lidhje me Gjykatën, ose në territorin e të cilit mund të kalojnë për detyra të tilla. Ata kanë gjithashtu për detyrë të mos përzihen në punët e brendshme të atij shteti.

Neni 25

Heqja e privilegjeve dhe imuniteteve që parashikohen nga nenet 13 dhe 14

Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara nga nenet 13 dhe 14 të kësaj Marrëveshjeje u jepen përfaqësuesve të shteteve dhe të organizmave ndërqeveritare jo për përfitime personale të vetë individëve, por për të ruajtur ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në lidhje me punën e Asamblesë, të organeve të saj ndihmëse dhe të Gjykatës. Për këtë arsye, Shtetet Palë jo vetëm që kanë të drejtë, por edhe për detyrë të heqin privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të tyre në çdo rast kur, në opinionin e atyre shteteve, ata kanë penguar dhënien e drejtësisë, dhe kjo mund të bëhet pa cenuar aspak qëllimin për të cilat këto privilegje dhe imunitete janë dhënë. Shteteve që nuk janë Palë të kësaj Marrëveshjeje dhe organizmave ndërqeveritare u jepen privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në nenet 13 dhe 14 të kësaj Marrëveshjeje me mirëkuptimin që ato të ndjekin të njëjtin detyrë për sa i përket heqjes së tyre.

Neni 26

Heqja e privilegjeve dhe imuniteteve të parashikuara nga nenet 15 deri 22

1. Privilegjet dhe imunitetet që parashikohen nga nenet 15 deri 22 të kësaj Marrëveshjeje jepen në interes të një administrimi të mirë të drejtësisë dhe jo për përfitime personale të vetë individëve që i përfitojnë ato. Këto privilegje dhe imunitete mund të hiqen në përputhje me nenin 48, paragrafi 5 i Statutit dhe dispozitat e këtij neni, dhe është një detyrë të veprohet në këtë mënyrë në çdo rast të veçantë kur ata pengojnë dhënien e drejtësisë. Kjo mund të bëhet pa cenuar aspak qëllimin për të cilat këto privilegje dhe imunitete janë dhënë.

2. Privilegjet dhe imunitetet mund të hiqen:

- a) Në rastin e një gjykatësi ose të prokurorit – nëpërmjet një shumice absolute të gjykatësve;
- b) Në rastin e referentit- nga ana e Presidencës;
- c) Në rastin e zëvendësprokurorëve dhe të stafit të zyrës së prokurorit - nga ana e prokurorit;
- d) Në rastin e zëvendësreferentit dhe të stafit të referentit – nga ana e referentit;
- e) Në rastin e personelit që i referohen nenit 17 – nga ana e shefit të organit të gjykatës që përgjigjet për punësimin e këtij personeli;
- f) Në rastin e avokatit dhe personave që asistojnë avokatin mbrojtës – nga ana e presidencës;
- g) Në rastin e dëshmitarëve dhe të viktimave – nga ana e Presidencës;
- h) Në rastin e ekspertëve, nga ana e shefit të organit të Gjykatës që cakton ekspertin;
- i) Në rastin e personave të tjerë që kërkohet të jenë të pranishëm në selinë e Gjykatës – nga ana e Presidencës.

Neni 27

Sigurimet shoqërore

Nga data kur Gjykata vendos një skemë të sigurimit shoqëror, personat që i referohen neneve 15, 16, 17, përsa i përket shërbimeve të bëra për Gjykatën, përjashtohen nga kontributet e detyrueshme ndaj skemave të sigurimeve shoqërore kombëtare.

Neni 28

Njoftimi

Referenti u komunikon në mënyrë periodike të gjitha Shteteve Palë për kategoritë dhe emrat e gjykatësve, prokurorin, zëvendësprokurorët, referentin, zëvendësreferentin, stafin e zyrës së prokurorit dhe avokatin për të cilin zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Referenti duhet t'u komunikojë gjithashtu të gjithë Shteteve Palë informacion të nevojshëm mbi ndryshimin e statusit të këtyre personave.

Neni 29

Lejekalimet

Shtetet Palë duhet të njohin dhe të pranojnë lejekalimin e Kombeve të Bashkuara ose dokumentin e punës të lëshuar nga Gjykata për gjyqtarët, prokurorin, zëvendësprokurorët, referentin, zëvendësreferentin, personelin e prokurorisë dhe të stafit të Sekretarisë, si dokumente të vlefshme udhëtimi.

Neni 30

Vizat

Aplikimet për viza ose leje hyrje-dalje, kur është e nevojshme, nga të gjithë personat të cilët janë mbajtës të lejekalimeve të Kombeve të Bashkuara ose të dokumentit të udhëtimit të lëshuar nga Gjykata, si dhe nga personat e përmendur në nenet 18 deri në 22 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët kanë një certifikatë të lëshuar nga Gjykata që konfirmon se ata po udhëtojnë me shërbim nga Gjykata, do të trajtohen nga Shtetet Palë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe do të jepen pa pagesë.

Neni 31

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me palët e treta

Pa cenuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Asamblesë sipas Statusit, Gjykata do të sigurojë mënyrat e përshtatshme të zgjedhjes së:

- a) mosmarrëveshjeve që lindin nga kontrata dhe mosmarrëveshjet e tjera të karakterit të së drejtës private në të cilën Gjykata është Palë;
- b) Mosmarrëveshje që përfshijnë çdo person të përmendur në këtë Marrëveshje, i cili, për shkak të pozicionit ose funksionit të tij ose të saj zyrtar në lidhje me Gjykatën, gëzon imunitet, në rast kur ky imunitet nuk është hequr.

Neni 32

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje midis dy ose më shumë Shteteve Palë ose midis Gjykatës dhe një Shteti Palë, do të zgjidhen me anë të konsultimit, negocimit ose ndonjë mënyrë tjetër zgjedhjeje për të cilën është rënë dakord.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni brenda një periudhe tremujore pas një kërkesë me shkrim nga njëra prej palëve të mosmarrëveshjes, me kërkesë të secilës palë, do t'i drejtohet një gjykatë arbitrazhi sipas procedurës të parashtuar në paragrafët 3 deri në 6 të këtij neni.

3. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë: një i zgjedhur nga secila palë e mosmarrëveshjes dhe i treti, i cili do të jetë kryetari i gjykatës, do të zgjidhet nga dy anëtarët e tjerë. Nëse ndonjëra nga palët nuk ka arritur të bëjë emërimin e një anëtari të gjykatës brenda dy muajsh të emërimit të një anëtari nga pala tjetër, kjo e fundit mund të ftojë kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ta bëjë këtë emërim. Nëse dy anëtarët e parë nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e kryetarit të gjykatës brenda dy muajsh pas emërimit, secila palë mund të ftojë kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të zgjedhë kryetarin.

4. Për sa kohë që palët e mosmarrëveshjes të mos bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë procedurën e saj dhe shpenzimet do të përballohen nga palët siç vlerësohen nga gjykata.

5. Gjykata e Arbitrazhit që do të vendos me shumicë votash, do të marrë një vendim në lidhje me mosmarrëveshjen në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe rregullave të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit do të jetë i formës së prerë për palët e mosmarrëveshjes.

6. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit do t'u komunikohet palëve të mosmarrëveshjes, referenti dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 33

Zbatueshmëria e kësaj Marrëveshjeje

Kjo Marrëveshje nuk cenon rregullat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare ndërkombëtare.

Neni 34

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet prej datës 10 shtator 2002 deri në 30 qershor 2004 në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

2. Kjo Marrëveshje është objekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga shtetet nënshkruese. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 35

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datë së depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Për çdo shtet që ratifikon, miraton ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të instrumentit të saj të ratifikimit pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 36

Amendimet

1. Çdo Shtet Palë, me anë të një komunikimi me shkrim drejtuar Sekretariatit të Asamblesë, mund të propozojë amendamente në lidhje me këtë Marrëveshje. Sekretariati do t'ia qarkullojë këtë komunikim të gjitha Shteteve Palë dhe Byrosë së Asamblesë me një kërkesë që Shtetet Palë njoftojnë Sekretariatit nëse ata mbështesin mbledhjen e një Konference Rishikimi të Shteteve Palë, për të diskutuar mbi propozimin.

2. Nëse brenda tre muajve nga data e qarkullimit nga Sekretariati i Asamblesë, një shumicë e Shteteve Palë njofton Sekretariatit se ata mbështesin mbledhjen e një Konference Rishikimi, Sekretariati do të informojë Byronë e Asamblesë me qëllim mbledhjen e kësaj Konference në lidhje me sesionin e ardhshëm të rregullt ose special të Asamblesë.

3. Miratimi i një amendamenti për të cilin nuk mund të arrihet konsensus do të kërkojë shumicën e dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe votuese, me kusht që të jetë e pranishme shumica e Shteteve Palë.

4. Byroja e Asamblesë do të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm në lidhje me amendimet që janë miratuar nga Shtetet Palë në një Konferencë Rishikimi. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë te të gjitha Shtetet Palë dhe shtetet nënshkruese çdo amendament të miratuar në Konferencën e Rishikimit.

5. Një amendim do të hyjë në fuqi për Shtetet Palë që kanë ratifikuar ose pranuar amendamentin gjashtëdhjetë ditë pasi dy të tretat e Shteteve që ishin Palë në datën e miratimit të amendamentit, të kenë

depozituar instrumentet e ratifikimit ose pranimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

6. Për çdo Shtet Palë që ratifikon ose pranon një amendim pas depozitimit, të numrit të kërkuar të instrumenteve, të ratifikimit ose pranimi, amendamenti do të hyj në fuqi ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose pranimi.

7. Një shtet që bëhet Palë në këtë marrëveshje pas hyrjes në fuqi të një amendimi në përputhje me paragrafin 5, duke mos u shprehur për një qëllim të ndryshëm nga ai shtet:

a) do të konsiderohet palë në këtë marrëveshje siç është amenduar; dhe

b) do të konsiderohet Palë në marrëveshjen e paamenduar në lidhje me çdo Shtet Palë që nuk është nën detyrimin për ta zbatuar amendimin.

Neni 37

Denoncimi

1. Një Shtet Palë, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, mund ta denoncojë këtë Marrëveshje. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit, përveç rasteve kur njoftimi specifikon një datë të mëvonshme.

2. Denoncimi nuk do të cenojë në asnjë mënyrë detyrën e çdo Shteti Palë për të përmbushur ndonjë detyrim të përfaqësuar në këtë marrëveshje, të cilit do t'i nënshtrohej sipas të drejtës ndërkombëtare, në mënyrë të ndarë nga kjo Marrëveshje.

Neni 38

Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 39

Tekstet autentike

Teksti origjinal i kësaj Marrëveshjeje me të cilin variantet në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësor autentike, do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Me dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar posaçërisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.